

30 years OF LOVE, SUSTAINABILITY AND COOPERATION Compact

Buletini i 30 vjetorit të Nehemiah Gateway! Nëntor 2021

Të dashur miq,

30 vite Nehemiah Gateway! Një përvjetor i mrekullueshëm. Askush nuk e ëndërronte një udhëtim të tillë, kur gjithçka filloi në vitin 1991. Organizata pati një rritje natyrale dhe u bë pjesë e komunitetit, që prej momentit që u nis për të zbutur sadopak nevojën e madhe që kishte në Shqipëri. Hodhi rrënjë të thella në vend.

Të ndash gëzimin dhe hidhërimin me banorët dhe komunitetin, të ndihmosh atje ku ka nevojë është e mrekullueshme. Të ofrosh ndihmë humanitare dhe mbështetje shpirtërore. Të fuqizosh njerëzit. Ky është edhe misioni i NG: të ndihmojmë dhe fuqizojmë njerëzit në nevojë, që në mënyrë të qëndrueshme të jetojnë jetët e tyre me dinjitet dhe pavarësi.

Dhe nuk ka humbur aspak nga freskia e saj! Frymëzon arsimimin e të rinjve nga vende të ndryshme, të cilët më pas do të ndërtojnë diçka komplet të re në vendet e tyre për veten dhe komunitetet e tyre.

Urime – edhe 30 vite të tjera!

Anke Neuzerling

Kryetare e Bordit Mbikëqyrës të NG



Shqipëri, 1991: Njerëzit kanë nevojë për ushqim dhe orientim në një botë të re.

Themelet e forta mund të përballojnë çdo stuhi

30 vjet histori ndërtimi dhe rindërtimi të Nehemiah Gateway

Historia e Nehemiah Gateway është një histori që tregon për ndërtim dhe rindërtim. Një histori që tregon për themelet e forta, të hedhura me kujdes për vite me radhë, për mure mbrojtëse dhe dyer që hapen. Është historia e një grupi njerëzish të përkushtuar që nëpërmjet punës së tyre, kanë ndryshuar jetë përgjatë gjithë këtyre viteve. Është një histori frymëzimi dhe individësh, të cilët e nisën duke marrë ndihmë dhe tani ndihmojnë nevojtarë të rimëkëmben.

Në vitin 1991, kur Arnold Geiger erdhi për herë të parë në Shqipëri, gjeti një komb të shkundur deri në themelet e tij. Shqiptarët ishin të uritur dhe të çorientuar, të vendosur para një bote të panjohur pas gati 50 vitesh izolim dhe një sistemi komunist ksenofob.



Nëntor, 1991 - Arnold Geiger me Peter Graf për herë të parë në Pogradec.



Operacioni 24 - 24.000 njerëz marrin ndihmë në 24 orë.



Takimi i përditshëm i lutjes në stadiumin e hendbollit.

NDIHMË

Ai kuptoi që vetëm sjellja e disa ndihmave nuk do të ndryshonte asgjë dhe nuk do të zgjidhte problemin. Në vitin 1991, Arnold Geiger i vuri vetes një mision: që të ndihmojë shqiptarët të rindërtojnë vendin e tyre, duke ardhur në Shqipëri nëpërmjet kufirit të Maqedonisë së Veriut dhe duke u vendosur në qytetin e Pogradecit, përgjatë Liqenit të Ohrit. Ai u kthye përsëri në vitin 1992 duke sjellë me vete një autokolonë me kamiona, të cilët ishin të mbushur me veshmbathje, ushqime, këpucë, lodra e deri tek biçikleta.

Të gjitha këto dhurata jetë-shpëtuese, të cilat erdhën në një kohë kur shqiptarët kishin kaq pak në përditshmërinë e tyre, u dhuruan nga individë në Gjermani, të cilët shpenzuan financat e tyre private, sende personale dhe gjithashtu kohën e tyre për t'i sjellë deri në Shqipëri.

Andy Ardüser ishte njëra prej tyre, pjesë e brezit të adoleshentëve dhe të rinjve, të cilët erdhën për të ndihmuar. "Shumë të rinj në kishë u pajisën me patenta ndërkombëtare", - kujton ajo. "Firmat e transportit na

lejuan të përdornim kamionet e tyre, por pa shoferë, kështu që në këtë mënyrë ne na u desh t'i ngisnim vetë." Sapo ndihmat mbërritën në Shqipëri duheshin shpërndarë menjëherë dhe kamionet duhet të ktheheshin në Gjermani brenda 24 orëve. Varfëria ishte kaq e tejskajshme në atë kohë, sa që nëse një kamion nga Gjermania qëndronte pak më gjatë i parkuar diku mund të çmontohej brenda pak orëve.

Dy nga donatorët tanë të hershëm, Ludwig dhe Edith Köcher kujtojnë ditët e para të udhëtimit për në Pogradec me kamionët me ndihma humanitare. "Ne kishim dëgjuar mbi varfërinë e Shqipërisë," - shprehet Ludwig, "por kur erdhëm këtu e kuptuam sesa të varfër ishin në të vërtetë."

Njerëzit në atë kohë mund të jetonin me shumë pak. Nuk kishte asnjë mbeturinë në tokë në atë kohë, sepse njerëzit gjenin përdorim për çdo gjë që kishin, edhe një copë të vogël litari. Gjatë komunizmit askush nuk ishte i sigurt se çfarë do të sillte e nesërmja, kështu që kursenin gjithçka. Dhe ata mund të riparonin gjithçka! Riparimet e makinave, të cilat në Gjermani kërkonin servise për t'i realizuar ato, në Shqipëri mund të kryheshin duke përdorur objektin më të vogël."

Ndihmat e sjella ishin për këdo në Pogradec. "Operacioni 24" quhej misioni i shpërndarjes, kujton Ludwig dhe Edith, nga i cili përfituan të gjithë banorët e qytetit nga një pako brenda 24 orëve. Shpërndarja u koordinua në mënyrë shumë të kujdesshme, me qendra grumbullimi në vende të ndryshme, që turmat të kontrolloheshin më mirë. Çdo kuti përmbante ushqime, veshmbathje dhe një Bibël.

Çdokush në Pogradec mori nga një kuti, përfshi edhe shumë persona që më pas u bënë pjesë e familjes së NG. Elis Tarelli, një djalosh 12-vjeçar asokohe, kujton shumë mirë një palë atlete Reebok, të cilat i ranë në pakon që ai dhe familja e tij morën. Ai akoma buzëqesh kur i kujton ato. "Ato ishin këpucët e para cilësore që kam patur ndonjëherë", - kujton ai. "Më rrinin pak të mëdhaja, por unë u rrita shpejt. Nuk ishin as shumë praktike në dëborë, por nuk e vrisja shumë mendjen, i vishja gjithsesi."

VLERA

Vlerat e NG i kanë rrënjët në krishtërim dhe së bashku me ndihmat humanitare kanë ofruar, por jo imponuar, mundësi informimi dhe jetese në besim. Në atë kohë,

kisha lokale kishte 300 pjesëmarrës dhe ishte një nga më të mëdhatat në Shqipëri. Kishte një kuriozitet shumë të madh mbi besimin në atë kohë. Shqipëria komuniste ishte një vend ateist, ku të gjithë drejtuesit fetarë ishin ekzekutuar ose burgosur nga regjimi diktatorial. Ekzistonte edhe një kuriozitet mbi të huajt, për shkak të izolimit shumëvjeçar nga pjesa tjetër e botës. Misionarët janë të vetëdijshëm që t'i sjellësh njerëzit në kishë nuk është njësoj si t'i bësh ata të besojnë në Krisht. Gjithsesi, t'i sjellësh në dyert e kishës është hapi i parë, edhe nëse mund të jetë i fundit për disa persona. Misioni i NG në Shqipëri ka qenë gjithmonë i rrënjosur në vlera, jo vetëm në formën e katalizatorit të besimit, por edhe në dhënien e shembullit të dashurisë pa kushte dhe dhembshurisë, pavarësisht prejardhjes dhe besimit të njerëzve. Ashtu siç edhe Drejtorja Ekzekutive, Herolinda Shkullaku, shprehet, -"Kam mësuar nga Arnoldi që njerëzve t'u jap besim që në fillim, në vend që të dyshoj dhe t'i bëj ata të fitojnë besimin tim. Nuk është mënyra shqiptare, por është mënyra ime tashmë."

FUQIZIM

Vitet e para të NG u përfshinë nga investime në ekonominë e Pogradecit. Ndihmat humanitare dhe frymëzimi shpirtëror nuk mjaftonin për të riparuar infrastrukturën e dëmtuar. Sipërmarrje, si servis makinash, zdrukhtari, klinikë dentare dhe furrë buke kaluan nën menaxhimin e NG, së bashku me një sërë organizimesh civile të reja sipërmarrëse, disa prej të cilave janë ekzistuese edhe sot.

SHKATËRRIM

Në vitin 1997, kolapsi i një skeme kombëtare financiare, çoi në protesta të dhunshme në të gjithë Shqipërinë. U vodhën municione të ngelura nga sistemi komunist dhe një sasi e konsiderueshme ra në duart e protestuesve. Rreth 2.000 mijë persona u vranë. Shumë sipërmarrje të reja dhe institucione u vandalizuan, përfshi dhe sipërmarrjet e reja të NG. Shumica e të huajve u larguan nga vendi, por skuadra e NG qëndroi, duke vëzhguar punën e tyre sesi shkatërrohej dhe sesi njerëzit, të cilët ishin përpjekur të frymëzonin me zemërgjerësi dhe dhembshuri shpërthyen në zemërim dhe shkatërrim. Manjola Kamolli, e cila iu bashkua kishës në kohën kur ishte studente dhe tani është zv. Drejtoresh Ekzekutive dhe Juriste për NG Albania, kujton se si raprezaljet vazhduan edhe përgjatë kohës kur çifti Geiger festonte përvjetorin e martesës. "Disa të rinj të kishës kishin vendosur që të organizonin diçka të bukur për ta, pavarësisht se gjërat nuk dukeshin edhe aq mirë, sepse



1996: Projekti i mensës për fëmijët e rrugës.



Projekti pilot: Furra e Nehemias (1996).



Shpërthime bombash gjatë trazirave kombëtare të vitit 1997.

ata ishin akoma këtu, nuk ishin larguar. Gjetëm një kovë me trëndafila nga një shitës që i kishte fshehur lulet në shtëpi për shkak të protestave. Shkuam në këmbë nga qyteti deri në Buçimas, me kovën me trëndafila. Rugët ngjasonin me zonë lufte dhe ne duhet të tregoheshim shumë të kujdesshëm. Ata u surprizuan dhe u gëzuan kaq shumë." Për të kujtuar vitin 1997, Arnold Geiger merr shembull pamje nga natyra. "Ajo kohë ishte si koha që plugojmë tokën dhe e përgatisim për të mbjellë," - tregon ai. NG mbolli sërish pas 1997. Krahas kishës, mensës për të varfërit dhe shërbimeve mjekësore, një rëndësi e madhe iu dha edukimit. Në vitin 1998, Shkolla NEHEMIA hapi dyert për herë të parë si një alternativë ndaj asaj që sistemi arsimor publik ofronte në atë kohë. Në mensën për të varfërit, bashkëpunëtorët vunë re që fëmijët që vinin nga komuniteti Rom ishin analfabet. Një klasë, që mori emrin "Klasa e Shpresës" filloi të jepte mësimet falas për këta fëmijë, si pjesë e Shkollës NEHEMIA. "Klasa e Shpresës" më pas mori emrin Shkolla Amaro Tan dhe drejtohej nga organizata "Të Rinjtë me një Mision" deri në vitin 2008, kur Arnold Geiger propozoi që kjo shkollë të vazhdonte si projekt edukativ i NG.

REFUGJATËT

Në vitin 1998 deri më 1999, përgjatë konfliktit serbo-kosovar, rreth 200.000 kosovarë u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe u strehuan në Shqipëri. Kufiri me Maqedoninë e Veriut, afër Pogradecit, ishte hyrja kryesore nga ku 3.000 refugjatë u strehuan në Pogradec deri në momentin kur ata mund të ktheheshin në shtëpitë e tyre. NG ishte pjesë e një koalicioni partnerësh që quhej "Projekti për Inkurajim në Pogradec", koalicion ky ku organizatat pjesëmarrëse bashkëpunonin për të mundur jo vetëm ushqim dhe strehim, por edhe përkujdesje për fëmijët, shërbime sociale, shpirtërore dhe mjekësore të gjitha familjet që ishin ndarë për shkak të largimit. Drejtorja Ekzekutive, Herolinda Shkullaku thotë: -"Gadishmëria e Shqipërisë për të ndihmuar një numër kaq të lartë njerëzish në nevojë dhe rrezik është diçka që gjithmonë na bën të ndihemi krenar."

Bob Baker erdhi në Shqipëri si pjesë e një kishe amerikane në përgjigje të krizës kosovare. Ai tregon se kosovarët u kthyen shumë shpejt në shtëpitë e tyre për shkak se Shqipëria ishte shumë e varfër në atë kohë. Kjo është një vlerë e shtuar në trashëgiminë e mikpritjes shqiptare, të cilët hapën dyert pa u menduar dy herë për refugjatët edhe atëherë kur ata vetë kishin aq pak.



Refugjatët nga Kosova në një nga kampet e sapondërtuara.



Diplomimi 2021 i studentëve të Shkollës së Lartë Nehemiah Gateway.

VITET 2000

Vitet 2000 ishin vitet ku u ndërtua mbi themelet që u hodhën në vitet 90. Shqipëria kishte arritur një lloj stabiliteti. Shkolla NEHEMIA u bë një institucion edukimi privat me kërkesa të shumta me mbi 400 nxënës të moshave 3-18 vjeç. Shkolla Amaro Tan ka mbi 100 nxënës nga kopshti në klasën e 9-të dhe qindra persona, të cilët marrin ndihmë sociale, mjekësore dhe humanitare çdo vit. Shumë të rinj shqiptarë të talentuar, të cilët e nisën si vullnetarë dhe përkthyes u bënë drejtuesit e ardhshëm të NG dhe organizatave të tjera.

Herolinda Shkullaku, e cila e nisi karrierën e saj si përkthyes, në vitin 2012 u emërua Drejtore Ekzekutive e NG Albania, një rast i rrallë drejtuese femër në një shoqëri patriarkale. Ajo gjithmonë ka me vete një mbajtëse çelësash prej argjendi, në formën e një njeriu, të cilën ia ka dhuruar Arnold Geiger si një simbolikë e njerëzve që ajo ka nën kujdesin e saj.

ZGJERIM

Përgjatë viteve 2000, i gjithë investimi në njerëz u zgjerua dhe u thellua. Shkolla e Lartë Nehemiah Gateway në Buçimas mirëpriti studentët e saj të rinj në vitin 2010 dhe në 2013 studentët e parë ndërkombëtarë nga Afrika dhe Amerika Qendrore. Këta studentë u përzgjedhën për shkak të mundësisë dhe dëshirës që ata kishin për t'u bërë shumëfishues të stabilitetit dhe frymëzimit. "Ata janë individë të cilët mund të sjellin ndryshimin në komunitetet e tyre," - siç shpjegon edhe Arlinda Merdani, Drejtuese e Projekteve Ndërkombëtare për NG.

Projekte të tjera me partnerë ndërkombëtarë kanë mundur NG që të ndihmojë organizata me të njëjtin këndvështrim të zgjerojnë impaktin e tyre. Në të njëjtën kohë, identifikimi i vullnetarëve, donatorëve dhe mbështetësve është një projekt global. NG ka qëlluar në të njëjtën kohë edhe me fat, por edhe strategjike në gjetjen dhe ruajtjen e grupeve vullnetare dhe donatorëve në Evropë, SHBA dhe vende të tjera. Ashtu siç shprehet edhe Kai Uellendahl, Anëtar i Bordit të Partnerëve dhe Drejtor Ekzekutiv i NG Zvicër - "Gjithçka është në shërbim të të munduruarit që njerëzit të mblidhen së bashku dhe të kenë një hapësirë për t'u takuar. NG gjen njerëz, të cilët mund të kontribuojnë me talentet e tyre dhe i sjell ata bashkë."

NDIHMË NËPËR FSHATRA

Megjithëse Shqipëria është zhvilluar shumë që prej vitit 1991, shumë nevoja mbeten akoma të paplotësuara. Fshatrat që gjenden në zona malore, të cilat në kohën e komunizmit mbështeteshin nga sistemi, tani janë kthyer në ishuj të vetmuar. Banorët e ngelur nëpër këto fshatra janë të kufizuar nga sëmundjet, pamundësitë fizike apo mosha dhe NG është në një mënyrë burim jete për ta. Shumë bashkëpunëtorë të NG i përshkruajnë udhëtimet që kanë bërë nëpër këto fshatra si eksperiencë më mbresëlënëse në punën e tyre. Programi i shpërndarjes së ndihmës nëpër fshatra të tregon një copëz realiteti mbi më të varfërit në Shqipëri dhe tregon impaktin që bujaria dhe dhembshuria kanë.

Gian Paul Ardüser, i cili ka shërbyer si Pastor dhe Drejtor Ekzekutiv dhe tani punon si konsulent i studentëve në Shkollën e Lartë Nehemiah Gateway, le të kuptohet se “ndoshta konteksti i Biblës gjendet më afër në Shqipëri se në Gjermani?”

PËRMIRËSIM

Shoqëria moderne shqiptare ka akoma shumë sfida me të cilat duhet të përballë-vendoset, por edhe njerëz me probleme mjekësore, materiale dhe shpirtërore. Në të njëjtën kohë po ecën përpara, me një të ardhme të shndritshme, me një mundësi anëtarësimi në Bashkimin Evropian në horizont. Ka përmirësim gjithashtu edhe në natyrën e mrekullueshme të Pogradecit. Kufizimet në gjueti kanë mundësuar përsëri ardhjen e shpendëve të ndryshëm në Liqenin e Ohrit dhe pyjet po mëkëmbejnë

30
Years

OF LOVE,
SUSTAINABILITY
AND COOPERATION

nga një kohë kur një popull i uritur dhe i pangrohur priste pyjet si dru zjarri.

Në këto 30 vite, NG ka themeluar institucione në bazat e ndershmërisë, frymëzimit, repsektit, faljes, dhembshurisë dhe integritetit. Ka ndryshuar jetët e dhjetra mijëra njerëzve në Shqipëri dhe përtej kufijve dhe vazhdon të ofrojë ndihmë, e cila ndryshon jetët e mijërave çdo vit. Kjo është një copëz e vogël e përkushtimit të disa vullnetarëve, bashkëpunëtorëve dhe miqve ndaj këtij misioni. Vizitoni dhe do të takoni akoma edhe më shumë. NG ka një histori që tregon për mundësi strehimesh dhe dyer të hapura, por mbi të gjitha është një histori që tregon mbi njerëzit.

Compact



Manjola Kamolli duke shpërndarë ndihma për banorët nëpër fshatra.



Fëmijët e kopshtit duke u argëtuar te Amaro Tan.



Projekti i ri i kopshtit të permakulturës pranë liqenit të Ohrit.




Luledielli: simbol në NG për rritjen dhe frytet.

Çfarë kuptimi ka një?

Emrat ndryshojnë me kohën. Deri në 2010, NG njihet si Fondacioni Nehemia. Për arsye qartësi ne i referohemi organizatës në publikime si NG edhe përgjatë kohës që quhej Nehemia.

Keni ndonjë histori që lidhet me NG? Skuadra e “Compact”, është e vetëdijshme që artikujt e paraqitur në këtë numër, janë vetëm një eksperiencë shumë e vogël e familjes së NG. Dëshira jonë ishte e madhe për t’i intervistuar të gjithë! Do të kishim shumë dëshirë që të dëgjonim prej jush në: sarah.pita@ng.team



Nga një fillim bamirësie në një organizatë ndërkombëtare

Arnold Geiger prezanton partnerët kyç në zhvillimin e NG

30 vjet bamirësi, qëndrueshmëri dhe bashkëpunim... Këto qëllime qëndrojnë të pandryshueshme që prej fillimit, por sot ato përfaqësojnë një punë ndërkombëtare që ka kaluar nga faza të ndryshme zhvillimi.

Arnold Geiger shpjegon: Organizata Humanitare Nehemia në Nidda dhe drejtuesi i saj karizmatik Waldemar Sardaczk luajtën një rol shumë të rëndësishëm në fillimet e NG. Ata na dërguan në mision si pjesë të familjes, morën përgjegjësinë për koordinimin dhe logistikën dhe kontribuan në shumë burime. Ata u kthyen në organizatën mëmë, në formë virtuale, për Nehemia Shqipëri. Edhe pse si NG ka shumë kohë që jemi të pavarur, ne kemi akoma kontakte dhe ruajmë një mirënjohje të madhe për ta. Përgjatë viteve NG është zhvilluar ndryshe nga shumë organizata me orientim të ngjashëm. Një arsye shumë e rëndësishme është: shumë profesionistë të fushave të ndryshme na kanë këshilluar dhe ndihmuar. Kjo mundësoi një rritje graduale dhe të organizuar. Çfarë filloi si një emergjencë u zhvillua në një program gjithëpërfshirës "të ndihmojmë për të ndihmuar vetveten".

Në mënyrë spontane, në mendje më vijnë tre personalitete që kanë luajtur një rol vendimarrës në zhvillimin e mëtejshëm të organizatës sonë: Alfred Wenig, Erich Stamminger dhe Paul Donders.

Paul Donders ka këshilluar skuadrën tonë drejtuese për shumë vite, duke na dhënë impulse shumë të rëndësishme, sidomos në momente kritike të zhvillimit të organizatës. Kjo na ka mundësuar që të tejkalojmë shumë kriza pa u dëmtuar. Akoma edhe sot, seminarët e tij janë "vegla" të profesionit për brezat e ardhshëm të drejtuesve.

Alfred Wenig ka patur një ndikim shumë të madh mbi mua, personalisht. Është e pamundur të mendojmë historinë e NG pa atë dhe jo vetëm se ai vendosi që NG të ishte trashëgimtare pas vdekjes së tij në janar të 2009-s, duke hapur pafundësisht mundësi të reja për ne, akoma edhe përtej botës tjetër. Alfredi zgjeroi horizontin tim me njohuritë e tij jo-tradicionale dhe të pakufijshme. Thëniet e tij të urta vazhdojnë të formojnë NG akoma edhe sot. "Askush nuk di aq shumë sa gjithkush." "Nuk ka asgjë të mirë deri sa ë bën ti." - këto janë dy nga shumë shembuj që mund të përmend. Theksi i tij mbi përgjegjësitë tona si njerëz, pikëpamja e tij mbi Izraelin dhe shoqërinë më kanë formuar. "Kisha krijohet nga komuniteti", nuk duhet ta harrojmë kurrë këtë gjë. Akoma edhe meraku i tij i madh mbi bujqësinë organike, që dikur është tallur shumë, ka komplet një kuptim të ri sot. Projekti i ri i permakulturës, të cilin djali i Arnoldit, Samueli po ndërton në Shqipëri me shumë përkushtim dhe entuziazëm, mban vulën e Alfredit.

Erich Stamminger është një tjetër person kyç, i cili ka lënë shenjë në tij. Ai u bë pjesë e organizatës në



Herolinda Shkullaku me Waldemar Sardaczuk - Një nga njerëzit e parë të NG.



Alfred Wenig bëri histori te NG.

2008, kur një fazë zhvillimi, komplet e re, po shfaqej në horizont për NG. Kjo gjë kërkonte një strategji të mirë, të fuqishme. Në fushën e zhvillimit të strategjisë, nuk besoj se mund të gjenim dikë më me eksperiencë. Si anëtar i Bordit Ekzekutiv të adidas, ai mundësonte këtë gjë çdo ditë dhe suksesi ishte i garantuar.

Me një strategji të re të zhvilluar me Erich, ish Nehemiah Albania shpejt mori edhe një emër të ri: Nehemiah Gateway, gjithashtu një logo të re. Një portë që simbolizonte sjelljen së bashku të mureve të vjetra të Jeruzalemit, të ndërtuara në Testamentin e Vjetër nga Nehemiah. Portat sillnin mbrojtje, por gjithashtu lejonin hapje dhe ndërsjellje dhe sillnin shpresë dhe dritë.

Një simbol shumë domethënës për punën tonë. Strategjia e re përfaqëson një tranzicion kyç: NG Albania kaloi nga një organizatë marrëse në një organizatë dhuruese. Që prej vitit 2012, përgjegjësia për punën në Shqipëri ka qenë në duart e afta të Herolinda Shkullakut dhe për shumë të rinj nga Evropa Juglindore, Amerika Latine dhe Afrika, NG Albania dhe Shkolla e Lartë Nehemiah Gateway janë vende ku mundësohen perspektiva të reja për të ardhmen.

Për shkak të orientimit të ri ndërkombëtar, entitete të reja të NG morën jetë. Sot, të gjitha fijet bashkohen te zyrat e NG Services në Nuremberg. Ato janë NG Albania, NG USA, NG Switzerland dhe zyra në Berlin. Hotel Lindenhof dhe MOHAB GmbH janë gjithashtu pjesë e NG Team, dhe në këtë vazhdimësi do të gjenerojnë të ardhura për të gjitha projektet e NG, pra, strategjia e zgjerimit ka funksionuar.

Roli im ka ndryshuar në vitet e fundit. Në të kaluarën, unë kam punuar pothuajse ekskluzivisht në fushat konceptuale dhe logjistike. Sot, roli im është që të

mundësojë që sa më shumë njerëzve t'u jepet mundësia të zhvillojnë punën logjistike vetë; që ata të kenë mundësinë dhe mjetet që në mënyrë aktive të formojnë hapat e ardhshëm në zhvillimin e organizatës. Sot, unë jam një motivues dhe një koordinator."

Njësoj si me patatet që ne shpërndamë nëpër fshatra në Shqipëri në kohët e fillimit, ndodh me të gjitha burimet tona: çfarë nuk është ngrënë (konsumuar) duhet mbjellë në tokë, si një investim për të ardhmen.

"Çfarë më frymëzon mua nga NG është përkushtimi juaj, mbi një të ardhme të shëndetshme për Shqipërinë. Dhe ky përkushtim nuk është thjesht i shprehur me fjalë, por i jetuar me dashuri dhe cilësi në të gjitha projektet që ju ndërtoni dhe zhvillon. Ju jeni një lloj ndriçuesi, ashtu si tradita e "Herrnhuters" gjermanë, të cilët gjithashtu kanë ndërtuar fshatra të reja në të gjithë botën përreth vitit 275 dhe kanë lënë një shenjë të thellë mirënjohjeje në komunitet. Ju keni respektin dhe vlerësimin tim!"

Paul Donders

"Arnoldi dhe e gjithë skuadra kanë bërë një punë të jashtëzakonshme në të ndihmuar njerëzit në Shqipëri. Koncepti i "të ndihmohet njerëzit që të ndihmojnë veten" më ka entuziazmuar që në fillim. Përkushtimi që Arnoldi, familja dhe skuadra e tij kanë treguar në jetën e përditshme ka qenë e pashoq. Për mua kishte vetëm një zgjidhje: të zgjerohej puna në vende dhe kontinente të tjera në mënyrë që të ndihmohen akoma më shumë njerëz. Duke parë rezultatet e sotme, jam me të vërtetë i impresionuar."

Erich Stamminger



Esther Geiger – Mbretëresha e Mikpritjes së NG

Në moshën 11-vjeçare, Esther Geiger shkoi me pushime me familjen e saj në një plazh në Jugosllavi. „Prej asaj kohe vendosa,“ - qesh ajo, „që do të jetoja në jug kur të rritesha.“ Shumë prej nesh bëjnë deklarata të tilla si fëmijë, por ajo e realizoi vërtet këtë dëshirë, ndonëse mënyra sesi ndodhi dhe përvojat që ka pasur, kanë qenë shumë më ndryshe nga çdo gjë që ajo mund të kishte imagjinuar. Kur Arnold Geiger vendosi në vitin 1991 për të shkuar në Shqipëri dhe për t’i ndihmuar njerëzit atje të rindërtonin jetën e tyre; e gjithë familja shkoi me të, Esther me tre fëmijët e vegjël dhe me një të katërt gati për të ardhur.

Përgjatë këtyre tridhjetë viteve në Shqipëri, familja Geiger ka mikpritur pafund miq dhe të gjithë kanë takuar Estherin dhe janë njohur me zemrën e saj të mirë dhe bujare, me kopshtet e saj të bollshme dhe shumëllojshmërinë e kafshëve, për të cilat ajo kujdeset. Esther e pranon faktin se fluksi i vazhdueshëm i vizitorëve bëhej edhe i lodhshëm ndonjëherë. Veçanërisht për fëmijët, koha e qetë „ajo vetëm me familjen“ ishte e vështirë të gjendej. Por, në të njëjtën kohë, rritja në një mjedis shumëgjuhësh dhe shumëkulturor ka qenë një avantazh i madh për ta. Sot, nipërit e vegjël të Arnoldit dhe Estherit, kur flasin, alternojnë anglishten, gjermanishten dhe shqipen, ndonjëherë edhe brenda së njëjtës fjali dhe ambientohen shumë lehtë me njerëz të kulturave të ndryshme. (Lexoni gjithashtu retrospektivën e vetë fëmijëve në faqen 10.)

Në fillim, familja Geiger jetonte në një shtëpi me qira në Pogradec, pa kuzhinë dhe me ujë të rrjedhshëm vetëm në tualet; e me gjithë vështirësitë e shumta në sigurimin e nevojave bazike, ata gjenin gjithmonë vend për miqtë.

„Unë gjithmonë isha duke gatuar,“ - kujton Esther. „Sigurisht që kisha ndihmë, por gjithmonë isha duke gatuar ose duke larë enët. Ndërkohë, fëmijët shkolloheshin në shtëpi.“ Megjithëse shtëpia e tyre e parë kishte vetëm dy dhoma gjumi, ata qëndronin të gjithë në një dhomë, për ta lënë dhomën tjetër të lirë për miqtë e tyre.

Një mori zërash nga fëmijët e lagjes që thërrisnin „Linnnn-DA, Linnnn-DA! E-VA! E-VA“ nga ora 7 e mëngjesit deri në orën 11 të natës, kërkonin vajzat Geiger që të dilnin e të luanin me to. Fëmijët e lagjes nuk kishin pothuajse asgjë, madje as këpucë për në dimër. Esther bëri të mundur, që ata të merrnin disa këpucë të dhuruara, të cilat prindërit e tyre i shitën, kështu që fëmijët e tyre mbetën sërish pa këpucë. Arnold e kujton këtë si fillimin e projektit të pakove të ndihmës nga NG, që ende sot siguron ushqim, veshje dhe këpucë për njerëzit në nevojë. Esther, e cila gjithashtu kishte ëndërruar që në fëmijëri të bëhej fermere, filloi të kujdesej për kafshët, qëkur u shpërngulën në Shqipëri. Filluan me pula dhe, për një kohë kujdeseshin edhe për lepuj. Shumë shpejt u shtuan edhe qentë e macet. Esther ka adoptuar dhjetra mace dhe qen përgjatë këtyre viteve dhe i ka çuar me shpenzimet e saj edhe te veterineri për t’i sterilizuar. Prej kësaj vjeshte, dy qen dhe një tufë macesh jetojnë në strehën paqësore të kampusit të NG-së në Buçimas.

Trazirat që pushtuan Shqipërinë në mars 1997, bënë që shumica e të huajve të largoheshin nga vendi. Kudo kishte dhunë dhe plaçkitje. Shumë investime të reja në një Shqipëri të re u shkatërruan pa arsye. Megjithatë, familja Geiger qëndroi. „Zotimi që ne kishim ndaj



Esther me një nga dhjetra macet që ka adoptuar ndër vite.



1996: Tavalina e madhe në shtëpinë e drurit në Buçimas ku Esther mikprit mija miq dhe bashkëpunëtorë.

popullit shqiptar duke ardhur këtu, do të thoshte se ne vërtet e ndjenim se duhej të qëndronim. Sidomos atëherë kur gjërat ishin keq.” - thotë Esther. Ajo kujton kohën kur rrinin mbyllur në shtëpi bashkë me fëmijët e tyre të vegjël, larg dritareve, ndërkohë që jashtë dëgjoheshin të shtëna armësh dhe shpërthime. Trauma dhe errësira e asaj kohe lanë gjurmë në memorien e Esther dhe këto kujtime ende e trishtojnë atë. „Kjo ishte koha kur ne vendosëm të fillonim me programet arsimore,” - thotë ajo. „E si mund ta parandalosh që të mos ndodhë sërish diçka e tillë?”

Sot, familja e madhe Geiger ka një shtëpi me shumë vend për miqtë, por edhe me një hapësirë private për familjen. Gjithashtu është edhe një shtëpi e veçantë vetëm për miqtë. Esther tashmë i ndan lehtë këto dy anë të përditshmërisë së saj. Sfidat e një organizate ndërkombëtare kanë krijuar një ekuilibër të ri, me një brez të ri lidheshi që vazhdon punën në Shqipëri. Kohët e fundit, Esther ka punuar me djalin e saj, Sam, në kopshtin e tij organik që ndodhet buzë liqenit. “Më pëlqen sesi ai punon te toka, me nxënësit e Shkollës NEHEMIA. Sam po iu mëson sesi të kujdesen për tokën dhe ta kuptojnë vërtet atë. Ka potencial për të bërë një ndryshim të madh.”



1992: Pa lavaman, pa hapësirë, por të gjithë janë të mirëpritur! Brigitte Weber, një nga bashkëpunëtorët e para, ndihmon në „kuzhinën” e parë të Esther.

LETRA NGA SHQIPËRIA

Në një kohë kur nuk kishte internet dhe ishte e vështirë të telefonojë me Gjermaninë, Esther shkruante shumë letra, dëshmi të shkruara me dorë të një kohe të trazuar, kur pavarësisht gjithçkaje, ajo nuk e kishte humbur sensin e humorit. Më poshtë jepen disa pjesë nga letrat e saj të vitit 1993:

Nuk mund ta imagjinoj dot sesa e komplikuar është gjithçka këtu. Dy-tre herë në ditë duhet të çojmë një enë të madhe plot me ujë në kuzhinë dhe në mëngjes ka shumë pak ujë të rrjedhshëm. Kështu pra, gjithë kohës jemi duke pritur... Në këtë situatë mungese uji, nuk mund të lahen as rrobat. Edhe kur ka presion të njaftueshëm të ujit, atëherë fillojnë problemet me energjinë elektrike. Kur lavatrica është në punë, nuk mund të gatujmë dhe as të ndezim ngrohësin. Ushqimin e gatuj kryesisht në sobë me dru. Arnoldi thotë gjithmonë se ushqimi ka shije të mirë, vetëm ngaqë ai e ndez kaq mirë zjarrin që herët në mëngjes. „Ndezja e zjarrit është gjysma e gatimit” Tipike e Arnoldit, kjo... ha ha...

Fëmijët e fqinjëve trokasin gjithmonë në derë, ndonjëherë çdo pesë minuta. Për më tepër, shumë njerëz të tjerë vijnë dhe kërkojnë diçka nga ne. Ndonjëherë thjesht qëndrojnë te dera për ta hapur dhe mbyllur atë. Duke qenë se sipas zakonit duhet të ofrosh gjithmonë kafe, më duket sikur gjithçka që bëj është të përgatit kafe dhe të laj fllaxhanë. Përtë mos përmendur pastaj sesa shpejt na mbaron kafeja...

Tashmë është ora 01:30 e mëngjesit. Më vonë do t'i kem duart plot. Katër burra duan të hanë dhe unë kam edhe katër fëmijët e mi. Shumicën e kohës ka edhe dy-tre miq shqiptarë për drekë. Kohë të trazura në kuzhinën time të vogël. Për darkë, kur të vijë Wolfgang Köcher, dua të përgatit pica. Mezi presim ta takojmë! Por tani për tani do ta mbyll...



1996 – Luisa, Arnold, Linda, Eva, Esther dhe Samuel Geiger



2021 – Familja me vajzën e tyre të vogël Clara (e dyta majtas)

Një fëmijëri si asnjë tjetër

Fotot më lart janë shkrepur në distancë kohore prej 25 vitesh; familja Geiger në tryezën e madhe prej druri rreth së cilës janë ulur gjatë këtyre viteve mijëra të ftuar. Tani, katër fëmijët janë rritur dhe familja është shtuar me ardhjen në jetë të Clarës. Na u duk me interes të dinim sesi këta fëmijë e shohin në retrospektivë fëmijërinë e tyre. Si i kanë përballuar ata kushtet, ndonjëherë edhe kaotike?

Vajza e madhe, Linda, ishte në klasë të parë kur familja u shpërngul në Shqipëri. Tani e sapomartuar, ajo punon në Gjermani si përkthyes për gjuhët anglisht, spanjisht dhe (sigurisht) shqip.

“E di me siguri, që nuk do të doja ta shkëmbeja fëmijërinë time me asnjë tjetër. Kur isha në Australi, kuptova se shumë nga gjërat që udhëtarëve me çantën e shpinës, iu dukeshin si zbulime të bukura, për mua ishin të njohura. E kam fjalën për udhëtimet me makina në rrugë malore, kampingje në natyrë të mrekullueshme dhe pranë kafshëve, si dhe të jetuarit mes njerëzve të mrekullueshëm dhe të jashtëzakonshëm. Kjo më bëri shumë mirënjohëse që prindërit tanë na “sollën me vete” në Shqipëri.

Mendoj se më bëri të kuptoj se çfarë do të thotë të jesh e huaj dhe më pas çfarë do të thotë të mos përceptohesh më si e tillë, por të pranohesh si pjesë e një shoqërie dhe kulture tjetër. Duke jetuar mes një larmie të madhe njerëzish, kam mësuar të jem shumë e hapur dhe fleksibël, për këtë arsye futem lehtësisht në kontakt me njerëzit e rinj që takoj.”

Fëmija i dytë, Eva, përfundoi trajnimin e saj në Gjermani për hoteleri dhe mikpritje dhe aktualisht, është përgjegjëse për mëngjesin, dhomat e miqve dhe trajnimet në NG Hotel Lindenhof.

“Mendoj se kemi pasur një fëmijëri të mrekullueshme, të larmishme, emocionuese dhe të lirë. Sigurisht, shpesh do të kishim dëshiruar më shumë vëmendje nga prindërit tanë. Po ashtu, kushtet kaotike, herë pas here, bëheshin të bezdisshme. Por, ne, fëmijët, që në moshë të vogël ishim të vetëdijshëm se prindërit tanë dhe miqtë e shumtë kishin një detyrë të rëndësishme për të përmbushur, për të cilën ata ishin të përkushtuar 100%. Ishte e qartë se kjo kërkonte edhe kontributin tonë, kështu që ne e vazhduam me kënaqësi. Nuk më ka munguar kurrë asgjë.

Por, më e rëndësishmja është se kemi pasur gjithmonë njëri-tjetrin si vëllezër dhe motra. Edhe sot, ndonëse (pothuajse të gjithë) jemi rritur, kemi një lidhje të fortë dhe qëndrojmë së bashku!”

Samueli është i martuar dhe ka dy djem. Ai është në një pozicion drejtues të NG në Shqipëri. Edhe Luisa u kthye në Shqipëri pas disa vitesh qëndrimi në Gjermani. Sot ajo drejton kuzhinën e mensës së shkollës dhe shtëpinë e miqve të NG në Buçimas. Kurse Clara ndjek klasën e dhjetë në Shkollën NEHEMIA.

Historitë e tyre flasin vetë. Rrethanat e vështira dhe sakrificat e shumta nuk kanë qenë disavantazh për ta, përkundrazi: kjo është një histori bekimi!

Biçikleta ime shumë e veçantë

Biçikleta e vogël vjollë e Lilit mbart një histori prekëse, që ja vlen të tregohet

“Nuk ndihem vetvetja pa biçikletën time të veçantë,” - thotë Lirika Prifti, e cila për shumë vite ka punuar te NG Albania si Drejtuese e Projektit të Mirëmbajtjes dhe Mikpritjes. Nëse e keni vizituar NG Albania në Buçimas vitet e fundit, me siguri e keni takuar Lilin. Ajo e drejtoi Shtëpinë e Miqve për më shumë se dhjetë vjet, krahas shumë përgjegjësi të tjera dhe gjithmonë me buzëqeshje në fytyrë. Shumicën e kohës, biçikleta e saj e vogël ngjyrë vjollë është e parkuar në anë të ndërtesës „Headquarter (HQ)“, dhe shumë punonjës të vjetër të NG do të komentnin se „nëse biçikleta ndodhet aty, atëherë aty është edhe Lili“. Siç shpjegoi edhe ajo, kjo biçikletë e veçantë i ka rrënjët te NG po aq thellë sa dhe vetë ajo.

Nuk është një biçikletë e zakonshme dhe jo vetëm për faktin se është shumë e dashur për të... Siç tregon ajo, në fillim të viteve 1990, kur përfundoi komunizmi në Shqipëri, babai i saj, me profesion marangoz, sapo kishte dalë në pension nga një karrierë e vështirë si minator. Kjo ishte puna që ai kishte bërë për të mbajtur familjen e tij. Pensioni që fitoi thjesht nuk i mjaftonte për të mbajtur një vajzë që studionte për letërsi dhe gjuhë shqipe në Universitetin e Elbasanit. Ai kishte marrë vesh për një organizatë të re gjermane që kishte ardhur së fundi në Pogradec dhe mundi të gjente punë me ta si marangoz. Ajo organizatë ishte Fondacioni Nehemia (e cila më vonë do të njëhej si NG).

Siç tregon Lili, në një nga dërgesat me ndihma nga Gjermania kishte biçikleta dhe babai i saj arriti të merrte një të tillë. Për Lilin ishte dashuri me shikim të parë. Edhe për të atin e saj ishte dashuri me shikim të parë. Ajo thotë se e ngacmonte vazhdimisht që t’ia jepte asaj, por ai i thoshte të njëjtën gjë që thotë ajo tani: - „Nuk ndihem vetvetja pa biçikletën time“. Ai e ngiste atë kudo dhe kjo biçikletë i sillte aq gëzim këtij minatori në pension. Ndërkohë, Lili jetonte në Shtetet e Bashkuara me bashkëshortin dhe dy fëmijët e saj të vegjël, por ende e mbante mend atë biçikletë të veçantë.



Lili dhe bashkëshorti i saj u kthyen në Shqipëri në vitin 2008. Kështu Lili filloi punë te NG. Në vitin 2015, pasi i ati vdiq nga një sëmundje në mushkëri, Lili trashëgoi biçikletën. “Kur u përpoqa ta ngisja për herë të parë pasi babai im vdiq,” - thotë ajo, “nuk mundja.... Më dukej sikur ai ishte ende atje, duke ngarë biçikletën me mua.... nuk ndihesha vetvetja.... Po dridhesha e gjitha dhe kur mbërrita në punë, në fakt u përplasa dhe lëndova mjekrën time.” Edhe sot ajo ka një shenjë të vogël nga përplasia. E tronditur, ajo ia dha biçikletën një kushërirë për ta riparuar. U deshën dy vjet dhe kur e mori sërish, kishte një shportë të madhe, një pasqyrë sigurie dhe një fener të vogël.

Që nga ajo kohë, ajo shkonte me biçikletë për në punë sa herë që mundte. „Është vendi im i lumtur,” - shton ajo, duke shpjeguar se i pëlqente koha e qetë dhe medituese në udhëtimin e saj të përditshëm për në punë. Ishte një kohë për të menduar, për të qenë vetëm dhe për t’u lutur. „Ka një vend buzë liqenit,” - thotë ajo. “Sa herë që kaloja, filloja të lutesha. Ndjej shumë mirënjohje. Unë jam mirënjohëse për jetën time, familjen time të dashur dhe do të jem gjithmonë mirënjohëse për punën time te Nehemiah Gateway Albania! Kjo karrierë te NG më dha gjithmonë mundësi për të mësuar, sfiduar veten dhe për t’u rritur. Ndihej e bekuar!

Pak pas shkrimit të këtij artikulli, pas vitesh pritjeje, Lili mori një vizë amerikane dhe u kthye në Shtetet e Bashkuara për të jetuar në Michigan me dy djemtë e saj të rritur. I urojmë suksese në këtë kapitull të ri të jetës. Ajo do të na mungojë shumë te NG!

TË REJA



NJË ÇMIM NDËRKOMBËTAR

Puna e NG njihet dhe vlerësohet edhe nga autoritetet. NG dhe Arnold Geiger janë vlerësuar disa herë për punën dhe angazhimin e tyre. Në Shqipëri janë dhënë tre tituj qytetar nderi, Urdhri Naim Frashëri dhe Urdhri Nënë Tereza për kontributin në mirëqenien e popullit në Shqipëri. Në vitin 2008, Arnold Geiger u nderua me Kryqin Federal Gjerman të Meritave.

Pikërisht në kohën e 30-vjetorit të Nehemiah Gateway, një tjetër çmim i njohur iu bashkua vlerësimeve të mëparshme: Një çmim ndërkombëtar nga Ministria Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, për angazhimin e jashtëzakonshëm personal për zbatimin e 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së. Më 28 tetor 2021, medalja u dha nga Ministri Federal Dr. Gerd Müller.

QËNDRONI TË INFORMUAR - TETË HERË NË VIT

Për të marrë buletin tonë rregullisht, vizitoni faqen tonë të internetit www.ng.team dhe aty mund të abonoheni për versionin e postës elektronike. Nëse e preferoni të printuar na shkruani në adresën MAR@ng.team dhe ne ju dërgojmë me postë.



TRAJNIM PËR NDËRGJEGJËSIM NDAJ AUTIZMIT

Nëpërmjet partneritetit tonë të vazhdueshëm me Rotary Clubs në Estes Park, Kolorado (SHBA), kemi patur mundësinë të zhvillojmë tre trajnime për mësues nga shkollat e Pogradecit, si dhe mësues të Shkollës NEHEMIA, rreth ndërgjegjësimit ndaj autizmit.

Dr. Migen Sulaj, një nga ekspertet kryesore në Shqipëri për autizmin në fëmijëri, diskutoi gjatë trajnimeve, sesi mund të zbulohet autizmi te fëmijët dhe si të punohet me ata fëmijë që mund të jenë në spektrin e autizmit.

Nehemiah Gateway Services
gemeinnützige GmbH
Kontumazgarten 3
90429 Nürnberg



T +49 911 60009960
F +49 911 60009969
office@ng.team
www.ng.team

IBAN: DE52 7605 0101 0011 7777 11
BIC: SSKNDE77XXX